



UNIVERSITETI I SHKODRËS
"LUIGJ GURAKUQI"

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

Udhëzues për studentët e rinj!

2025-2026


www.unishk.edu.al





- **Rektorati**
- **Palestra e USH-së**
- **Biblioteka e USH-së**
- **Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN)**
- **Fakulteti i Drejtësisë (FD)**
- **Fakulteti Ekonomik (FE)**
- **Fakulteti i Shkencave Shoqërore (FSHSH)**
- **Fakulteti i Shkencave të Edukimit (FSHE)**
- **Fakulteti i Cjohëve të Huaja (FGJH)**

Ky material u përgatit nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët & Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"



Fjalë përshëndetëse e Rektorit

*Të dashur studente dhe studentë,
Mirë se erdhët në Universitetin "Luigj Gurakuqi"
të Shkodrës!*

Është privilegj dhe kënaqësi t'ju presim në një prej institucioneve më të hershme të arsimit të lartë në vend, që mbart mbi supë një traditë të pasur kulturore, qytetare dhe intelektuale. Shkodra ka qenë qysh në shekuj qendër e dijes dhe e mendimit kritik, vatër e botimeve të para në gjuhën shqipe dhe e figurave që kanë ndriçuar kulturën kombëtare. Universiteti ynë është vazhdimësi e kësaj trashëgimie: një hapësirë ku e kaluara ndërthuret me të ardhmen.

Ju keni zgjedhur të studioni në Shkodër, jo thjesht për një diplomë, por për t'u bërë pjesë e një qyteti që ka qenë gjithnjë i hapur ndaj dijes dhe përparimit, ku tradita e kulturës shkollare ndërthuret natyrshëm me sfidat e kohës. Emri i universitetit tonë mban Luigj Gurakuqin – një prej figurave më të ndritura të kombit, atdhetar, mendimtar e përhapës i dijes – shembull që na frymëzon edhe sot, për të lidhur studimet me përgjegjësinë qytetare dhe guximin për reforma.

Sot, universiteti ynë synon të udhëheqë reformat akademike dhe teknologjike, duke integruar në mësimdhënie e kërkim zhvillimet më bashkëkohore si, inteligjenca artificiale dhe aplikimet e saj ndërdisiplinore. Në mënyrë që krahas rritjes së cilësisë në mësimdhënie të jemi po aq të integruar ndërkombëtarisht, prej kësaj universiteti dhe stafet e tij sfidohen dhe krijojnë frymëmarrje për inovacionin.

Si rektor, angazhimi im është që universiteti "Luigj Gurakuqi" të vazhdojë reformimin me studentin në qendër – qasje që e sheh studentin, jo vetëm si përfitues të dijes, por dhe si bashkëkrijues të saj. Ne besojmë se universiteti duhet të qeveriset me dhe për studentët, duke u bërë një komunitet i gjallë, ku zëri juaj dëgjohet dhe ku ndërtohet së bashku e ardhmja.

*Ju falënderoj që keni zgjedhur të nisni këtë rrugëtim në Shkodër dhe ju uroj suksese, krijimtari dhe guxim në kërkimin tuaj akademik!
Mirë se erdhët në një traditë që tashmë është edhe e juaja!*

Prof. Dr. Tonin Gjuraraj
Rektor i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"



Të dashur studente dhe studentë,

Është kënaqësi e veçantë për mua, që në cilësinë e dekanit të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, t'ju uroj mirëseardhjen në këtë hapësirë të dijes, të kërkimit shkencor dhe të zhvillimit individual. Zgjedhja juaj për të studiuar në Fakultetin tonë shënon një hap të rëndësishëm drejt formimit tuaj të ardhshëm akademik dhe profesional, por njëkohësisht edhe drejt ndërtimit të një vizioni më të gjerë për shoqërinë ku jetojmë.

Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka luajtur dhe luan një rol tepër të rëndësishëm në zhvillimin rajonit, por edhe më gjerë.

Detyra e tij është që me rritjen progresive të njohurive shkencore t'u përgjigjet nevojave të shoqërisë gjithnjë në rritje, të ndikojë në njohjen dhe në kultivimin e kulturës e të vlerave më të mira kombëtare e europiane, duke synuar të çojë para zhvillimin e arsimit, të kulturës dhe të shoqërisë në të gjithë rajonin.

Ky Fakultet ka një traditë të gjatë në përgatitjen e profesionistëve të aftë për të analizuar, kuptuar dhe ndikuar në zhvillimet shoqërore. Përmes programeve tona studimore ne synojmë t'ju pajisim ju, studentët tanë, me njohuri teorike solide, me aftësi kërkimore dhe me kompetenca praktike që do t'ju ndihmojnë të përballoni me sukses sfidat e së ardhmes. Ndaj ju inkurajoj të shfrytëzoni maksimalisht të gjitha mundësitë që ju ofron Fakulteti ynë: leksionet, seminarët, projektet kërkimore dhe veprimtaritë jashtë auditorit, si dhe ju ftoj të jeni aktivë në jetën studentore, sepse përvoja universitare nuk është vetëm mësim, por edhe shkëmbim idesh, ndërtim miqësish dhe zhvillim i aftësive shoqërore.

Jam i bindur se vitet tuaja këtu do të jenë vite të një rritjeje të gjithanshme, ku secili prej jush do të gjejë hapësirën e nevojshme për të kultivuar pasionet, për të formuar mendimin kritik dhe për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për veten dhe për shoqërinë tonë.

Fillimi i një viti të ri akademik natyrisht ruan emocione të veçanta, sidomos për ata që ulen për herë të parë në auditoret e këtij Universiteti. Duke u bashkuar me emocionet dhe gëzimin tuaj, në emër të të gjithëve ju uroj një fillim të mbarë dhe suksese në rrugën e bukur, por edhe të vështirë të studimeve universitare. Shumë të tjerë janë të impenjuar thellësisht në vijimin e studimeve, duke u përpjekur të arrijnë më të mirën e mundshme. Që të gjithë ju jeni duke jetuar vitet më vendimtare të jetës, vitet në të cilat ju do t'i përkushtoheni përgatitjes shkencore e profesionale, vite në të cilat ju do të formoheni për të përballuar me sukses valët e jetës.

Prandaj kam kënaqësinë e veçantë t'ju uroj të gjithëve fillim të mbarë të këtij viti akademik dhe t'ju jap besimin e plotë se stafi pedagogjik dhe ai administrativ do t'ju krijojnë mundësitë për të shprehur vetveten, për t'u përgatitur dhe për të marrë përgjegjësi si qytetarë të denjë të këtij vendi.

Jam i sigurt se së bashku do t'ia dalim të arrijmë rezultate të vlefshme.

Prof. dr. Artan HAXHI
Dekani i Fakultetit të Shkencave Shoqërore

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"	5
Fakulteti i Shkencave Shoqërore	8
Pjesë nga Regullorja e Studimeve	11
Platformat e Studentëve	16
Sekretaritë Mësimore	18
Këshillat Studentorë	18
Bursat & Tarifat	19
Ndërkombëtarizimi	20
Klubet Studentore	22
Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët	24
Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	26
Infrastruktura	27
Biblioteka e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"	27
Palestra e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"	29
Mensa studentore	29
Konvikti i studentëve	29
Pedagogët sipas departamenteve	30

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

02.09.1957

U themelua Instituti i Lartë Pedagogjik 2 vjeçar i Shkodrës me Fakultetin e Shkencave të Natyrës.

1970-1971

ILP i Shkodrës u kthye nga 2 vjeçar në 3 vjeçar

1982-1983

ILP i Shkodrës u kthye nga 3 vjeçar në 4 vjeçar

28.05.1991

Fitoi statusin ligjor si Universitet: Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi".
Në përbërjen e tij do të kishte: Fakultetin e Shkencave Shoqërore, Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Fakultetin e Ciklit të Ulët

01.09.1991

Fakulteti i Ciklit të Ulët emërtohet Fakulteti i Shkencave të Edukimit.

13.05.1996

U themeluan Fakulteti Ekonomik & Fakulteti i Drejtësisë

20.01.2001

U themelua Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

2004-2005

Zbatimi i Sistemit të Bolonjës



Fakultetet

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Departamenti i Biologji-Kimisë
Departamenti i Fizikës
Departamenti i Matematikës
Departamenti i Lëndëve Paraklinike
Departamenti i Lëndëve Klinike
Qendra e Studimit të Ujërave të
Rajonit të Shkodrës

FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Departamenti i Mësuesisë
Departamenti i Psikologjisë
dhe Punës Sociale
Departamenti i Edukimit Fizik
dhe Sporteve
Departamenti i Arteve

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

Departamenti i Gjuhës Shqipe
Departamenti i Letërsisë
Departamenti i Historisë
Departamenti i Gjeografisë
Qendra e Studimeve Albanologjike

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Departamenti i Gjuhës Angleze
Departamenti i Gjermanistikës
Departamenti i Romanistikës

FAKULTETI I DREJTËSISË

Departamenti i të Drejtës Publike
Departamenti i të Drejtës Civile
Departamenti i të Drejtës
Ndërkombëtare dhe Evropiane

FAKULTETI EKONOMIK

Departamenti i Administrim-Biznesit
Departamenti i Financë-Kontabilitetit
Departamenti i Turizmit

Shifra & Fakte

Aktualisht, USH-ja ofron 74 programe studimi të ndryshme në tre ciklet e studimit:

Cikli i Parë – Bachelor (**30** programe studimi)

Cikli i Dytë – Master i Shkencave (**24** programe studimi), Master Profesional (**13** programe studimi), Program i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (**1** program studimi)

Cikli i Tretë – Doktoraturë (**2** programe studimi)

Gjithashtu, ofrohen **3** Programe Profesionale dhe **1** Program Studimi i Formimit të Vazhduar.

Studentë të
Diplomuar Bachelor:

34993

Studentë të Diplomuar
Master Profesional:

2199

Studentë të Diplomuar
Master Shkencor:

1325

Shkolla
Doktorale:


13

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" është akredituar me vendim të ASCAL Nr. 03, datë 24.01.2020.

Stafi akademik i USH-së konsiston në:

Kategoria Prof. Dr. **14**
Kategoria Prof. As. Dr. **46**

Kategoria Dr. **87**
Kategoria Msc. **53**



- Kategoria Prof. Dr
- Kategoria Prof. As. Dr
- Kategoria Dr.
- Kategoria Msc.

Staf joakademik në USH: 120

Fakulteti i Shkencave Shoqërore

Fakulteti i Shkencave Shoqërore (FSHSH) është një ndër njësitë themelvënëse të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Ai u formësua mbi traditën e Institutit të Lartë Pedagogjik dhe u konsolidua si fakultet me dy drejtime kryesore studimi: Gjuhë–Letërsi dhe Histori–Gjeografi.

Brenda tij funksionon Qendra e Studimeve Albanologjike, e cila përbën shtyllën qendrore të profilimit akademik të fakultetit dhe ka kontribuar në zhvillimin e kërkimeve gjuhësore e kulturore, si në rrafshin sinkronik, ashtu edhe në atë diakronik. Në kuadër të kësaj tradite, fakulteti ofron programe studimi që mbështeten fort mbi albanologjinë, duke nxjerrë në dritë periodikun shkencor "Studime shqiptare".

Për një periudhë kohe, pranë tij ka funksionuar edhe Këshilli i Profesorëve, i cili ka kontribuar në promovimin dhe zhvillimin e karrierës akademike të stafit pedagogjik. Sot, Fakulteti i Shkencave të Shoqërore ka 40 pedagogë, prej të cilëve 4 mbajnë titullin "Profesor", 9 "Profesorë të asociuar", 22 "Doktorë", 2 "Docentë" dhe 3 MSc.



MISIONI

Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka si mision formimin dhe kualifikimin e studentëve në të gjitha ciklet, përgatitjen e specialistëve në fushën e gjuhësisë, të letërsisë, të historisë, të gjeografisë, të gazetarisë, por edhe të disiplinave të përafërta kulturore, si: redaktorë gjuhësorë dhe letrarë, punonjës biblioteke, ciceronë muzesh dhe guidë turistike, zëdhënës shtypi e specialistë të sektorit të komunikimit, etj. Gjithashtu ky fakultet përmes programeve të studimit Master Profesional (Shkencor) në Mësuesi synon formimin e mësuesve të kualifikuar në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Përmes programeve të studimit Master Shkencor dhe Doktoratë synohet formimi i specialistëve të profilimit të lartë në fushat e sipërpërmendura, si: pedagogë, studiues e kërkues shkencorë.

POLITIKA E CILËSISË

Fakulteti i Shkencave Shoqërore kujdeset dhe shquhet për cilësinë e studimeve në arsimin e lartë në të gjitha ciklet. Ai vepron në fushën e formimit kulturor dhe profesional, duke synuar arritjen e standardeve të larta dhe konkurruese në profilet e përmendura në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar, si dhe kujdeset për formimin dhe përditësimin e njohurive. .

ÇFARË OFRON FAKULTETI?

- ☑ Programe studimi në të dy ciklet për të gjitha profilet e studimit, ndërsa për Gjuhën shqipe edhe në nivel doktorate.
- ☑ Kurrikula të larmishme dhe të përditësuara që u japin mundësi studentëve të përballen dhe të jenë të suksesshëm në tregun e punës.
- ☑ Staf akademik të kualifikuar brenda dhe jashtë vendit, me përvojë akademike, që ofron një mësimdhënie bashkëkohore.
- ☑ Personalitete me kontribute të veçanta nga fushat kërkimore që mbulojnë dhe bashkëpunim në kërkimin shkencor.
- ☑ Përfshirjen e të gjithë stafit të fakultetit jo vetëm në procesin mësimor, por edhe në kërkimin shkencor përmes botimeve me vlerë konkurruese në nivel kombëtar e ndërkombëtar, në fushat përkatëse.
- ☑ Infrastrukturë mbështetëse për studentët, mjedise me hapësira të përshtatshme dhe teknologji bazë, pajisje dhe programe kompjuterike, internet, bibliotekë universitare etj.
- ☑ Bashkëpunim të ngushtë student-pedagog dhe mbështetje të vazhdueshme për formimin profesional e shkencor të studentëve.
- ☑ Lidhje të teorisë me praktikën përmes ekspeditave, praktikave profesionale, laboratorëve dhe punëve praktike.
- ☑ Mobilitet të studentëve në kuadrin e projekteve të ndryshme ndërkombëtare.
- ☑ Bashkëpunim me fakultetet simotra brenda dhe jashtë vendit, si dhe me qendra të rëndësishme kërkimore-shkencore.

Fakulteti i Shkencave të Edukimit

18.04.1957

Bachelor në "Gjuhë – Letërsi"
(VKM Nr.150 prot.)

20.02.2006

Bachelor në "Histori"
(Shkresë MASH Nr. 1127 prot.)
Bachelor në "Gjeografi"
(Shkresë MASH Nr. 1127 prot.)

27.04.2006

Bachelor në "Gazetari dhe
Komunikim"
(Shkresë MASH Nr. 2743 prot.)

24.09.2008

Master i nivelit të parë në
"Mësuesi në Gjuhë – Letërsi"
me 60 kredite (VKM nr. 1291 prot)

07.10.2011

Cikli i tretë "Doktoratë" në
"Gjuhë Shqipe" (VKM nr. 498 prot)

31.05.2013

Master i Shkencave
"Studime Regjionale në Gjeografi"
(Urdhër Nr. 212 prot)

03.07.2020

"Udhërrëfyes Turistik dhe
Menaxhues i Itinereve Turistike
për Rajonin Verior" (Urdhër nr. 196)

17.09.2021

Riorganizim i programit
të studimit të Ciklit të dytë
Master profesional në
"Mësuesi në Gjuhë – Letërsi"
me 120 kredite (Urdhër Nr.332)

20.07.2022

Bachelor në "Gjeografi
dhe Zhvillim Territori"
(VKM nr. 440)

04.10.2022

Master i Shkencave në
"Studime të Historisë
dhe të Kulturës Shqiptare"
(Urdhër Nr. 583)

2022 - 2023


Riorganizim i programit
të studimit të Ciklit të tretë
"Doktoratë" në "Gjuhë Shqipe"
(Urdhër Nr. 773 prot)
Pedagogë e punonjës të
Fakultetit të Shkencave
Shoqërore (2022)

26.08.2024

Master Shkencor në "Mësuesi
Histori dhe Gjeografi"
(Urdhër Nr. 456 prot)

30.05.2025

Master Profesional në
"GIS dhe Planifikim Territori"
(Urdhër Nr. 222 prot)



Organizimi i Fakultetit

Dekan i Fakultetit të Shkencave Shoqërore

Prof. Dr. Artan Haxhi
artan.haxhi@unishk.edu.al

Zv. Dekan i Fakultetit të Shkencave Shoqërore

Dr. Dritan Rustja
dritan.rustja@unishk.edu.al

Sekretare e Dekanit:

Doriana (Shpori) Deda
dorina.deda@unishk.edu.al

Sekretare mësimore:

Gjuhë-Letërsi dhe

Gazetari – Komunikim

Elsa Aga
elsa.ag@unishk.edu.al

Histori dhe Gjeografi

Ardjana Loku
ardjana.loku@unishk.edu.al

IT i Fakultetit

Rovena Mesi (Dibra)
rovena.mesi@unishk.edu.al

Departamentet e FSHSH-së:

Departamenti i Gjuhësisë

Drejtores e Departamentit
Prof. As. Dr. Orjeta Baja
orjeta.baja@unishk.edu.al

Departamenti Letërsisë

Drejtores e Departamentit
Dr. Bendis Kraja
bendis.kraja@unishk.edu.al

Departamenti i Gjeografisë

Drejtores e Departamentit
Dr. Flora Gjoni
flora.gjoni@unishk.edu.al

Qendra e Studimeve Albanologjike

Drejtores e Qendrës së
Studimeve Albanologjike:
Prof. As. Dr. Zamira Shkreli
zamira.shkreli@unishk.edu.al

Programet e studimit:

Bachelor

Gjuhë - Letërsi
Gazetari dhe Komunikim
Histori
Trashëgimi kulturore
Gjeografi
Gjeografi dhe Zhvillim Territori

Program studimi me karakter profesional

"Udhërrëfyes Turistik dhe
Menaxhues i Itinerareve
Turistike për Rajonin Verior"

Master profesional

Master Profesional në
"Mësuesi në Gjuhë – Letërsi"
Master Profesional në
"GIS dhe Planifikim territori"

Master i Shkencave

Master i Shkencave në
"Studime të Historisë dhe të Kulturës Shqiptare"
Master i Shkencave
"Studime Regjionale në Gjeografi"
Master i shkencave në
"Mësuesi Histori dhe Gjeografi"

Pjesë nga Rregullorja e Studimeve

Neni 4

Ciklet e studimit dhe afatet e tyre

1. Programet e studimeve në USH organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme :

- a. Studime të ciklit të parë.
- b. Studime të ciklit të dytë.
Master i shkencave
Master profesional
- c. Studime të ciklit të tretë

2. Kohëzgjatja e studimeve

Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.

Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për te rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kriterëve dhe procedurave të shpal-lura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të Njësisë Bazë të institucionit që pranon studentin, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloren e saj.

Neni 5

Viti akademik

1. Studimet në USH zhvillohen në vite akademike. Data zyrtare e fillimit të vitit akademik shpallet nga ministri përgjegjës për arsimin. Viti akademik organizohet në semestra. Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe me vendim të Rektoratit hartohet struktura mësimore e vitit akademik e ndarë në javë mësimore dhe javë për provime e riprovime.

Neni 7

Cilësimi "student"

Cilësimi "student" fillon me regjistrimin në USH dhe mbaron me marrjen e diplomës, me largimin ose me përjashtimin nga USH. Gjatë gjithë kësaj periudhe studenti është i detyruar të zbatojë Statutin dhe rregulloret e USH-së.

Neni 22

Sistemi i vlerësimit

1. Vlerësimi i përparimit të studentëve bëhet me notë.

2. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej 10 notash. Nota me e ulët për kalim në një disipline është 5.

3. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit kthehet detyrimisht në notë.

4. Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuara në programin e disiplinës/modulit dhe vlerësimi në provim. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për lëndët/modulet e cilësuar provim në planin mësimor përfaqëson 20-40% të vlerësimit përfundimtar.

Neni 27

Regjistrimi i studentëve në sistem

1. Studentët e rregullt regjistrohen në sistem për pjesëmarrje në provim nga Sekretaria Mësimore. Pedagogët duhet të çojnë në SM listën e studentëve që për shkak të mungesave nuk futen në provim.

2. Studentët përsëritës të vitit të parë dhe vitit të dytë regjistrohen në provimet e kursit nga sekretaria mësimore.

Neni 31

Sezonet e zhvillimit të provimeve të kursit

1. Provimet në USH organizohen në dy sezone:

Sezoni i parë: Pas përfundimit të procesit mësimor të semestrit të parë organizohet provim për të gjitha disiplinat e zhvilluara në këtë semestër, që në planin mësimor janë shënuar si provime.

Sezoni i dytë: Pas përfundimit të procesit mësimor të semestrit të dytë organizohet provim për të gjitha disiplinat e zhvilluara në këtë semestër, që në planin mësimor janë shënuar si provime.

2. Riprovimet në USH organizohen në 2 sezone:

Sezoni i vjeshtës: gjatë muajit shtator. Në këtë sezon studentët kanë të drejtë të shlyejnë deri në 6 provime të mbetura të vitit në vazhdim apo të bartura nga vitet paraardhëse.

Sezoni i pranverës: gjatë vitit shkollor përkatës (në periudhën mars-prill). Në këtë sezon studentët kanë të drejtë të shlyejnë deri në 6 provime të bartura.

Neni 40

Të drejtat dhe detyrat e studentit

Studenti ka të drejtë:

- Të përdorë, sipas rregulloreve përkatëse, të gjitha mundësitë dhe (infrastrukturën) pajisjet që ofron universiteti për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor;
- Të përfitojë bursë studimi brenda ose jashtë shtetit, kur plotëson kushtet e përcaktuara me aktet e normave në fuqi;
- Studenti provohet vetëm një herë për përmirësim note dhe vetëm në sezonin e riprovimeve të vjeshtës. Kur studenti nuk paraqitet mbetet në fuqi nota e parë;
- Studentit prapambetës i njihen detyrimet e shlyera në vitet paraardhëse në përputhje me programin e vitit që vazhdon;

Studenti është i detyruar:

- Të njohë dhe të zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Statuti i Universitetit, nga kjo "Rregullore" dhe nga çdo akt tjetër ligjor e nënligjor. Në të kundërt USH nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre;
- Studenti është i detyruar të përgjigjet për programin mësimor që është miratuar për vitin akademik që ai ndjek;
- Të shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara në planin mësimor dhe në programet e disiplinave të veçanta.
- Të zhvendosë, sipas rregullave në fuqi, të gjitha dëmtimet e vlerave materiale të kryera prej tij;
- Të shlyejë detyrimet e reja që lindin për shkak të ndryshimeve që mund të jenë bërë në planin mësimor
- Të paguajë tarifën eshkolimit sipas afateve të përcaktuara nga Rektorati
- Të zbatojë të gjitha rregullat e etikës

Rregullorja e studimeve mund të jetë objekt ndryshimi, ndaj gjithmonë referoju ndryshimeve të fundit.



https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2024/rregullore/Vendimi_i_Senatit_akademik_nr_182_date_28.05.2019.pdf
https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2024/rregullore/4456_12062020121424.pdf



Për t'u informuar më tej në lidhje me Statutin e USH, Vendime të Senatit, Rregullore institucionale, etj, mund t'i gjeni në linkun më poshtë
<https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/rektorati#c181>



Platformat e Studentëve

Adresa Elektronike Zyrtare e Studentit

Çdo student pajiset me një adresë e-maili zyrtare në formatin:
`emër_mbiemër@unishk.edu.al`

Pajisja me adresën elektronike është e rëndësishme sepse:

- ✓ Përbën mjetin kryesor të komunikimit mes studentëve dhe stafit akademik.
- ✓ Siguron akses në njoftime zyrtare, materiale mësimore dhe shërbime universitare.
- ✓ Përdoret për hyrjen në platformat online të studimeve.

Përmes saj mund të aksesoni paketën Office 365 (Word, Excel, PowerPoint, Teams, OneDrive etj.). Për udhëzime mbi përdorimin e aplikacioneve vizitoni:
Instruksione Office 365



Sistemi i Pitagorës

Sistemi elektronik Pitagora është platforma zyrtare e Universitetit të Shkodrës për menaxhimin e të dhënave studentore.
Përmes tij studentët mund të:

- Regjistrohen në lëndë dhe provime
- Shohin rezultatet e provimeve
- Gjurmojnë progresin akademik
- Marrin njoftime zyrtare nga fakulteti

Si të regjistroheni?

- ✓ Hyni në faqen zyrtare të sistemit Pitagora: <https://ushk.pitagora.rash.al/login>
 - ✓ Përdorni adresën institucionale të e-mailit të Universitetit të Shkodrës (emri_mbiemri@unishk.edu.al).
 - ✓ Vendosni fjalëkalimin tuaj (i cili jepet nga përgjegjësi i IT-së në momentin që do të keni të aktivizuar adresën e studentit).
 - ✓ Tek menuja do të gjeni informacione që lidhen kryesisht me provimet, librezën e notave, mungesat dhe kurrikulën e detajuar mësimore.
- Kontakt: it@unishk.edu.al



Microsoft Teams – Komunikimi dhe Bashkëpunimi Online

Microsoft Teams është platforma zyrtare për komunikim dhe bashkëpunim midis studentëve dhe pedagogëve. Ajo mundëson leksione online, takime me video, biseda dhe ndarje skedarësh.

Si të hyni:

- ✓ Shkarkoni aplikacionin Microsoft Teams (PC ose celular).
- ✓ Hyni me adresën zyrtare të e-mailit it@unishk.edu.al.
- ✓ Zgjidhni ekipin/lëndën/klasën ku jeni regjistruar. Zakonisht klasa hapet nga pedagogu i lëndës. Ai mund t'ju regjistrojë direkt në klasën e tij virtuale, ose ju jep një kod që ju të regjistroheni në atë klasë.

Përdorime kryesore:

- ✓ Ndjekja e mësimet online dhe takime me pedagogët.
- ✓ Komunikimi me grupin e kursit.
- ✓ Shkëmbimi i materialeve dhe skedarëve.



Sekretaritë Mësimore

Struktura e sekretarive është pjesë e strukturës së përgjithshme të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Sekretaritë mësimore janë struktura ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore dhe kanë për mision funksionimin, organizimin dhe shërbimin ndaj studentëve dhe stafit akademik. Sekretaria mësimore e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" përbëhet nga Kryesekretaria dhe Sekretaritë Mësimore të fakulteteve, të cilat janë përgjegjëse për programet e studimit sipas ndarjes së miratuar nga Dekani i Fakultetit.

Ju mund t'i drejtoheni sekretarisë së programit ku studioni për vërtetime të ndryshme si: vërtetim notash të pjesshme, vërtetim notash të plota, vërtetim i thjeshtë studenti, regjistrime, çregjistrime, tërheqje diplomash, etj.

Zakonisht, orari i pritjes së studentëve pranë sekretarive mësimore është nga e hëna në të premte, ora 12.00-14.00.

Këshillat Studentore

Këshillat e Studentëve janë struktura të pavarura të krijuara dhe drejtura nga vetë studentët, me qëllim përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të tyre brenda institucioneve të arsimit të lartë. Këshillat krijohen në bazë të ligjit për arsimin e lartë dhe rregulloreve të brendshme të universitetit. Ato nuk janë politike apo ekonomike në natyrë dhe nuk lidhen me organizata jashtë universitetit. Universiteti mbështet dhe financon veprimtaritë e Këshillave të Studentëve, duke u dhënë hapësirë për t'u zhvilluar dhe për të ndikuar realisht në përmirësimin e jetës studentore.

Misioni i Këshillave

- ☑ Të promovojnë pjesëmarrjen aktive të studentëve në jetën universitare.
- ☑ Të përfaqësojnë studentët në organet vendimmarrëse të universitetit.
- ☑ Të japin mendime dhe propozime për çështje me interes studentor.

Parime të përgjithshme

- ☑ Anëtarët e këshillave zgjidhen çdo 2 vjet përmes votimeve nga të gjithë studentët.
- ☑ Këshillat Studentorë të Fakulteteve (KSF) të USH-së, përbëhen nga 3 anëtarë.
- ☑ Këshilli Studentor Institucional (KSI) i USH-së, përbëhet nga 5 anëtarë.
- ☑ Kryetar i KSF apo KSI, zgjidhet automatikisht kandidati që është votuar më shumë nga lista e kandidatëve pjesëmarrës në garë.
- ☑ Nëse një anëtar përfundon studimet, zëvendësohet nga kandidati pasardhës në listën e votimeve.

Këshillat e Studentëve japin opinione dhe sugjerime për:

- ✓ Programet e studimit dhe rregulloret akademike
- ✓ Tarifat e shkollimit dhe shërbimet studentore
- ✓ Buxhetet dhe përdorimin e fondeve
- ✓ Aktivitetet kulturore, artistike dhe sportive
- ✓ Të drejtën për të studiuar dhe cilësinë e mësimdhënies

Rregullore e Këshillave Studentorë

https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/rregullore/Rregullore_per_zgjedhjet_e_keshillave_te_studenteve_ne_Universitetin_Luigj_Gurakuqi.pdf



Bursat & Tarifat

Në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", studenti mund të përfitojë bursa si më poshtë:

Bursa me kriter ekonomik

- ✓ Studentët nga familje me ndihmë ekonomike.
- ✓ Bashkëshortët me fëmijë, kur të dy janë studentë.
- ✓ Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuara nga komisioni mjekësor.
- ✓ Studentët me të dy prindërit pensionistë, ose me një prind pensionist dhe tjetrin të ndjerë.
- ✓ Studentët që janë fëmijë i tretë (ose më shumë) në familje me të paktën tre fëmijë, ku dy të parët studiojnë në universitete publike.
- ✓ Studentët me status jetimi, deri në moshën 25 vjeç.
- ✓ Studentët deri në moshën 25 vjeç që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë.
- ✓ Studentët deri në moshën 25 vjeç me status ligjor si viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore.
- ✓ Studentët që janë fëmijë të punonjësve të Policisë, Gardës, Forcave të Armatosura, SHISH-it, apo Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye të detyrës.

Bursa për arritje të larta akademike

- ✓ Studentët, të cilët kanë notë mesatare 9-10: bursë + përjashtim nga tarifa e shkollimit
- ✓ Studentët me mesatare mbi 6 (gjashtë): përgjysmim i tarifës së shkollimit

Bursa për programe prioritare

- ✓ Studentët që ndjekin degët prioritare të përcaktuara sipas udhëzimit të ministrisë

Bursa për mobilitet ndërkombëtar Erasmus+

- ✓ Studentët e Universitetit të Shkodrës kanë të drejtë të aplikojnë çdo vit për thirrjet e mobilitetit në universitete evropiane.

Çfarë duhet të bësh?

- ✓ Ndiq njoftimet për mobilitet në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës: www.unishk.edu.al
- ✓ Përgatit dokumentacionin sipas udhëzimeve të thirrjes.
- ✓ Kontakto me Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë për sqarime dhe asistencë në adresën iroshkoder@unishk.edu.al

Për informacione të mëtejshme në lidhje me bursat:
<https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/rektorati/drejtoria-e-finances-dhe-buxhetit/bursa>



Për informacione të mëtejshme në lidhje me tarifat e shkollimit:
<https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/rektorati/drejtoria-e-finances-dhe-buxhetit/tarifa-shkollimi>



Ndërkombëtarizimi

Universiteti ofron një gamë mundësish ndërkombëtare për të zgjeruar përvojën akademike dhe profesionale. Këto mundësi ndihmojnë studentët të zgjerojnë horizontet, të praktikojnë njohuritë e marra dhe të përgatiten për tregun global të punës.

"Credit Mobility" është pjesë e programit **Erasmus+**, i cili mundëson **shkëmbimin e studentëve** ose stafit akademik apo administrativ për një periudhë të kufizuar kohënë një universitet tjetër, me qëllim që të marrin mësim, të japin mësim ose të zhvillojnë trajnim, dhe pastaj të kthehen në institucionin e origjinës.

- ✓ **Studentët** shkojnë për një semestër ose një vit akademik në një universitet partner. Kreditet që fitojnë atje (ECTS) njihen në universitetin e origjinës.
- ✓ **Stafi akademik** mund të shkojë për të dhënë mësim në një universitet tjetër.
- ✓ **Stafi administrativ** mund të marrë pjesë në trajnime apo shkëmbime pune.

Qëllimi: forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, përmirësimi i cilësisë së arsimit, shkëmbimi kulturor dhe zhvillimi i aftësive.



Universiteti i Shkodrës ka disa marrëveshje Credit Mobility të nënshkruara me Universitete partnere. Ndër më kryesoret janë:

- ☑ University of Vechta, Germany
- ☑ University of Varna, Bulgaria
- ☑ University of Almera, Spain
- ☑ University of Economics, Prague
Czech Republic
- ☑ University of Complutense, Spain
- ☑ University of Economics Krakow, Poland
- ☑ University of Jean, Spain
- ☑ University of Ostravia, Czech Republic
- ☑ University of Vidzeme, Letonia
- ☑ University of Foro Italico, Italy
- ☑ Università degli Studi di Messina, Italy
- ☑ Università degli studi di Bergamo, Italy
- ☑ Università degli studi di Bologna, Italy
- ☑ Università della Campania "Luigi Vanvitelli", Italy
- ☑ University of Warsaw, Poland
- ☑ University of Camerino, Italy
- ☑ Faculty of Natural Sciences, Nursing,
Sud Tirol
- ☑ University of Timisoara, Romania
- ☑ University of Salento, Italy
- ☑ COMMO IX European programme -
ERASMUS + KA171
- ☑ Saxon University
- ☑ University of Bari "Giuseppe Degennaro"
(LUM), Italy

Klubet studentore

Klubet studentore janë grupe të organizuara nga studentët për të ndjekur aktivitete të caktuara, që mund të lidhen me fusha akademike, pasione personale, çështje shoqërore, kultura të ndryshme apo thjesht argëtim. Ata funksionojnë brenda mjedisit universitar dhe zakonisht mbështeten nga universiteti përmes hapësirave, burimeve ose udhëzimeve.

Pse janë të rëndësishëm?

Klubet ofrojnë mundësi për t'u angazhuar në aktivitete që e pasurojnë jetën universitare.

Pjesëmarrja në klube studentore ndihmon studentët të:

- ☑ Zhvillojnë aftësi udhëheqëse dhe bashkëpunimi
- ☑ Ndërtojnë miqësi dhe rrjete profesionale
- ☑ Përfjethesojnë universitetin përtej klasës
- ☑ Përgatiten më mirë për tregun e punës

Klubet studentore në Universitetin e Shkodrës

Klubi Studentor "Fryma e Natyrës"

Mbrojtja e mjedisit dhe aktivitetet ekologjike
auroa.dibra@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Tesla"

Projekte në fushën e fizikës dhe teknologjisë
senada.jubica@unishk.edu.al

Klubi Studentor "MediKlub"

Aktivitete për studentët e infermierisë
vera.gjinaj@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Ndihma e Parë"

Trajnime dhe simulime për situata emergjente
julian.kraja@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Ernest Koliqi"

Arti i fjalës dhe aktivitete letrare
ismet.kallaba@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Arshi Pipa"

Arti i fjalës dhe aktivitete letrare
anisa.kosteri@unishk.edu.al


Klubi Studentor "Mozaik"

Diskutime mbi historinë dhe shoqërinë
anelmo.spahija@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Eksploratorët e Veriut"

Eksplorimi i natyrës dhe guidë turistike
orjeta.baja@unishk.edu.al





Klubi Studentor "Artan Bushati"

Sport dhe aktivitet fizik
erjon.peqini@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Vildan Tufi"

Aktivitete sportive, edukative dhe shoqërore
ditmar.jubica@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Observe"

Psikologji dhe zhvillim personal
elona.hasmujaj@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Books and Friends"

Lexime, diskutime dhe lidhje përmes librave
ambra.hysa@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Vehbi Hoti"

Trashëgimi, edukim dhe vizion për të ardhmen
rina.gera@unishk.edu.al

Klubi Studentor i Arteve

Art, muzikë, pikturë, teatër, poezi
dorjan.ulaj@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Ratio Legis"

Diskutim dhe analizë e çështjeve ligjore
eugena.bisha@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Smart Business Hub"

Zhvillim idesh dhe aftësish për botën e biznesit
elvisa.drishiti@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Travel Thinkers"

Eksplorim kulturor dhe ide për udhëtime
gentian.memaj@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Financa dhe Investimet"

Aftësi praktike në fushën financiare
peter.saraçi@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Xhiro në Shkodër"

Zbulim i vendeve turistike dhe trashëgimisë kulturore
elton.shpuza@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Klubi Letrar"

Letërsi dhe krijimtari në gjuhën gjermane
karoline.kuttner@unishk.edu.al

Klubi Studentor "Kulturë dhe Jo Vetëm"

Kulturë, gjuhë italiane dhe aktivitete artistike
lindita.kazazi@unishk.edu.al

Klubi Studentor "English Club"

Gjuhë, kulturë angleze e amerikane dhe aktivitete artistike
nivis.deda@unishk.edu.al

Të interesuarit mund të kontaktojnë koordinatorët e klubeve për më shumë informacion apo për t'u bërë pjesë aktive!

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët është struktura e universitetit që merret me ndërtimin dhe forcimin e komunikimit me studentët, median, komunitetin dhe partnerët institucionalë. Ajo koordinon aktivitetet studentore, promovon imazhin e universitetit dhe siguron transparencë e informim të vazhdueshëm për jetën akademike dhe sociale.

Sektori i Marrëdhënieve me Studentët është pjesë e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët. Ky sektor ka për qëllim mbështetjen, orientimin dhe fuqizimin e studentëve gjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe profesional. Nëpërmjet një sërë aktiviteteve të organizuara me kujdes dhe vizion, krijohen ura lidhëse ndërmjet studentëve, alumnëve dhe tregut të punës.

Disa nga shërbimet që ofron ky sektor për studentët janë:

- ✓ Mbështetja dhe këshillimi i studentëve
- ✓ Komunikimi dhe informimi
- ✓ Organizimi i eventeve dhe aktiviteteve studentore
- ✓ Përfaqësimi i interesave të studentëve
- ✓ Zgjidhja e problemeve dhe konflikteve
- ✓ Mbështetja për integrimin dhe përfshirjen
- ✓ Mbështetja për karrierën dhe punësimin



Aktivitetet Kryesore të Organizuara:

Panairi i Punës dhe i Karrierës

Panairi i Punës dhe i Karrierës është një nga ngjarjet më të rëndësishme për punësimin e studentëve dhe të diplomuarve. Ky aktivitet krijon hapësirë takimi midis studentëve, të diplomuarve dhe përfaqësuesve të bizneseve e institucioneve. Ai u ofron të rinjve mundësi për t'u njohur me tregun e punës, për të mësuar mbi praktikat profesionale dhe ofertat e punës, si dhe për të ndërtuar kontakte të vlefshme për karrierën e tyre. Ky panair zhvillohet një herë në vit (zakonisht gjatë muajit Maj).

Çmimi i Karrierës

Çmimi i Karrierës në universitet organizohet me qëllim vlerësimin dhe shpërblimin e studentëve e të diplomuarve që janë dalluar për arritjet e tyre akademike, profesionale dhe angazhimin në aktivitete shoqërore. Ai synon të inkurajojë përpjekjet individuale, të promovojë shembuj frymëzues suksesi dhe të forcojë lidhjen midis universitetit, tregut të punës dhe komunitetit.

Forumi i Alumnëve

Forumi i Alumnëve në universitet është një platformë bashkimi për ish-studentët, që synon forcimin e lidhjeve me universitetin, shkëmbimin e përvojave profesionale dhe krijimin e rrjeteve të reja bashkëpunimi. Ai shërben si hapësirë për dialog, mentorim dhe nxitje të mundësive të reja në karrierë e zhvillim personal.

Ceremonia e Diplomimit

Ky aktivitet është një moment solemn dhe festiv, ku vlerësohen përpjekjet, arritjet dhe përkushtimi i studentëve, duke i bërë ata pjesë të komunitetit të gjerë të alumnëve të universitetit. Përveçse një ditë krenarie për studentët dhe familjet e tyre, ceremonia e diplomimit forcon lidhjen mes universitetit, shoqërisë dhe tregut të punës, duke nënvizuar rolin e arsimit të lartë në formimin e profesionistëve të së ardhmes.

Trajnime me ekspertë

Spektori i Marrëdhënieve me Studentët ofron një gamë trajnimesh praktike me ekspertë për zhvillimin personal dhe profesional të studentëve si: shkrimi i CV-së dhe i letrës së motivimit, aftësitë e intervistës së punës, zhvillimi i aftësive të buta (soft skills), menaxhimi i karrierës, aftësi prezantimi dhe të folurit në publik, aftësi negociimi dhe lidhshp.

Panairi "Work & Study" – Forumi i Karrierës dhe Studimeve

Ky është një event ku të rinjtë prezantohen me ofertën akademike të universitetit. Për më tepër ata njihen me mundësitë për punësim, praktika profesionale dhe programe të mëtejshme studimi, brenda dhe jashtë vendit. Gjatë këtij aktiviteti realizohen sesione informuese dhe këshillim për karrierën.

Vizitoni zyrën tonë:

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët

Rektorati-Sheshi 2 Prilli, Kati i I

Kontakti në: alumni_karriera@unishk.edu.al



Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Në Universitetin "Luigj Gurakuqi" funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila ka për qëllim vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe infrastrukturës.

Çfarë roli kanë studentët?

- ☑ Studentët vlerësojnë nëpërmjet pyetësorëve periodikë cilësinë akademike, infrastrukturën dhe shërbimet.
- ☑ Përgjigjet e tyre janë anonime dhe përdoren vetëm për përmirësimin e cilësisë në universitet.
- ☑ Duke marrë pjesë, studentët kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e standardeve të studimeve dhe jetës universitare.

Pse është e rëndësishme?

- ☑ Studentë japin mendime për leksionet, praktikat dhe mënyrën e mësimdhënies.
- ☑ Ndihmojnë në përmirësimin e shërbimeve dhe ambienteve universitare.
- ☑ Kjo siguron që zëri i tyre të dëgjohet në proceset vendimmarrëse.

Infrastruktura

Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka një infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë e procesit mësimor. Laboratorët luajnë një rol të rëndësishëm në projektet shkencore dhe në aktivitetet me studentët. Përmendim këtu:

- ✓ Laboratorët e doktoraturës së Gjuhës shqipe, të gazetarisë, salla e projekteve dhe auditorin A3.
- ✓ Në dispozicion të programit të studimit "Gazetari – Komunikim" është laborator i multimedias, që funksionon si studio televizive dhe radiofonike. Ky laborator përdoret për realizimin e praktikave profesionale dhe mundëson pjesëmarrjen e studentëve në konkurse dhe projekte multimediale.
- ✓ Po ashtu në fakultet është dhe laborator digjital ku zhvillohet mësim, prezantohen detyrat e kursit dhe punimet e diplomave të studentëve.
- ✓ Në dispozicion të departamentit të Gjeografisë janë laboratorët e GIS-it (Sistemet e Informacionit Gjeografik) dhe të Gjeografisë
- ✓ Departamenti i Historisë ka në dispozicion së fundmi një laborator bashkëkohor mbi Trashëgiminë Kulturore, të ndërtuar në bazë të një projekti me të njëjtën tematikë.



Biblioteka e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Biblioteka Universitare, e themeluar në vitin 1957, ka sot një fond prej rreth 111,000 librash në shqip dhe gjuhë të huaj, që mbulojnë të gjitha fakultetet e universitetit. Godina aktuale e bibliotekës, një godinë bashkëkohore me tre kate dhe me sipërfaqe rreth 3000 m², është përfunduar në vitin 2006.

Biblioteka zotëron koleksione të pasura si:

- ✓ Fondin albano – ballkanologjik;
- ✓ Fondin shqip dhe të shkencave filologjike të albanologjisë;
- ✓ Fondin e huaj;
- ✓ Bibliotekën austriake;
- ✓ Fondin e periodikut shqip dhe të huaj;
- ✓ Fondin e fakulteteve.



Në bashkëpunim me bibliotekën e qytetit "Marin Barleti" është krijuar portali: "Arkivat Digjitale Shkodër", i cili do vijë duke u pasuruar me vepra të tjera të trashëgimisë kulturore.

Biblioteka ofron për përdoruesit e saj një sërë shërbimesh si: shërbimin e informacionit dhe të huazimit, vë në dispozicion të tyre mediatekën, me 26 vende multimedia, si dhe tri salla leximi me 300 vende leximi në total. Godina e bibliotekës ka në përbërjen e saj edhe sallën e konferencave "Hoeflechner", me një kapacitet 120 vende, e cila mundëson zhvillimin e një sërë aktiviteteve të karakterit akademik, mësimeve apo promovuese.

Orari: Hënë–Premte 08:00–19:00 / Shtunë 08:00–13:00

Adresa: Rr. Jeronim De Rada, Shkodër, Albania

Email: bush@unishk.edu.al



Palestra e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Palestra e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” është ndërtuar në vitin 2003. Ajo është një ndërtesë polivalente që disponon dy mjedise ku zhvillohen sportet e rënda & fitness-aerobia si edhe sala e madhe 30m x 20m (600m²), gjithsej 750 m², ku zhvillojnë mësimin praktik studentët e programit të Edukimit Fizik e Sporte në lëndët e: basketbollit, volejbollit, gjimnastikës dhe orët praktike të lëndëve meto-dike të edukimit fizik.

Ndërtesa është e pajisur edhe me ambientet ndihmëse si banjo, dhomat e zhveshjes si për vajza dhe për djem dhe magazina e materialeve sportive.

Kjo palestër ka ndihmuar shumë në rritjen e aktivitetit të universitetit duke zhvilluar veprimtari të ndryshme sportive të organizuara nga Departmenti i Edukimit Fizik e Sporte. Këto veprimtari kanë ndikuar në përmirësimin e jetës aktive të studenteve duke i dhënë mundësi që të zhvillojnë aktivitete sportive brenda universitetit por dhe shkëmbime sportive me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Mensa studentore

Në shërbim të studentëve të Universitetit “Luigj Gurakuqi” funksionon mensa studentore, ofruar nga Bashkia Shkodër. Ky shërbim synon të garantojë ushqim të shëndetshëm dhe me çmime të përbalueshme për të gjithë studentët.

Mensa është menduar si një mbështetje konkrete për jetën e përditshme të studentëve, duke ofruar jo vetëm ushqim cilësor, por edhe një hapësirë sociale ku ata mund të kalojnë kohë së bashku jashtë orëve të mësimi.

Konvikti i studentëve

Studentët e Universitetit “Luigj Gurakuqi” kanë mundësi të përfitojnë nga akomodimi në konviktin studentor të ofruar nga “Trajtimi Studentor” Sh.a. Shkodër. Ky shërbim ofrohet me tarifa të përbalueshme dhe është i menduar për të lehtësuar jetesën gjatë studimeve.

Konvikti ofron:

- ☑ Dhoma të përshtatshme për studentë;
- ☑ Kushte bazë për jetesë dhe studim;
- ☑ Një ambient social ku studentët mund të krijojnë përvoja të përbashkëta jashtë auditorit.

Ky shërbim është një mbështetje e rëndësishme për studentët që vijnë nga rrethet apo që kanë nevojë për akomodim pranë universitetit.

Pedagogët sipas departamenteve

Departamenti i Gjuhësisë

Nr	Emër Mbiemër	Adresa elektronike
1	Prof. Dr. Mimoza Priku	mimoza.priku@unishk.edu.al
2	Prof. As. Dr. Orjeta Baja	orjeta.baja@unishk.edu.al
3	Prof. As. Dr. Rrezarta Draçini	rrezarta.dracini@unishk.edu.al
4	Dr. Rezearta Murati	rezearta.murati@unishk.edu.al
5	Doc. Bora Logu	bora.logu@unishk.edu.al
6	Dr. Merita Hysa	merita.hysa@unishk.edu.al
7	Dr. Anisa Kosteri	anisa.kosteri@unishk.edu.al
8	Dr. Aida Uruçi	aida.uruci@unishk.edu.al

Departamenti i Letërsisë

Nr	Emër Mbiemër	Adresa elektronike
1	Prof. Dr. Ledri Kurti (Kraja)	ledri.kurti@unishk.edu.al
2	Prof. As. Dr. Arben Prendi	arben.prendi@unishk.edu.al
3	Prof. As. Dr. Vincens Marku	vincens.marku@unishk.edu.al
4	Prof. As. Dr. Valbona Karakaçi	valbona.karakaci@unishk.edu.al
5	Prof. As. Dr. Elinda Dibra	elinda.dibra@unishk.edu.al
6	Prof. As. Dr. Gëzim Puka	gezim.puka@unishk.edu.al
7	Dr. Ardian Hoti	ardian.hoti@unishk.edu.al
8	Dr. Laert Miraku	leart.miruku@unishk.edu.al
9	MSc. Ismet Kallaba	ismet.kallaba@unishk.edu.al

Departamenti i Historisë

Nr	Emër Mbiemër	Adresa elektronike
1	Prof. Dr. Nertila Ljarja	nertila.ljarja@unishk.edu.al
2	Prof. As. Dr. Simon Lufi	simon.lufi@unishk.edu.al
3	Prof. As. Dr. Ilirjana Kaceli	ilirjana.kaceli@unishk.edu.al
4	Dr. Bendis Kraja	bendis.kraja@unishk.edu.al
5	Dr. Sereta Koperaj	sereta.kapera@unishk.edu.al
6	Dr. Marsel Nilaj	marsel.nilaj@unishk.edu.al
7	Dr. Eduard Ndreca	eduard.ndreca@unishk.edu.al
8	MSc. (Doktorant) Anelmo Spahija	anelmo.spahija@unishk.edu.al

Departamenti i Gjeografisë

Nr	Emër Mbiemër	Adresa elektronike
1	Prof. As. Dr. Bresena Kopliku	bresena.kopliku@unishk.edu.al
2	Prof.As. Dr. Medjon Hysenaj	medjon.hysenaj@unishk.edu.al
3	Dr. Flora Gjoni	flora.gjoni@unishk.edu.al
4	Dr. Dritan Rustja	dritan.rustja@unishk.edu.al
5	Dr. Ervis Krymbi	ervis.krymbi@unishk.edu.al
6	Dr. Nertila Dilaveri	nertila.dilaveri@unishk.edu.al
7	Dr. Ylber Dyli	ylber.dyli@unishk.edu.al

Qendra e Studimeve Albanologjike

Nr	Emër Mbiemër	Adresa elektronike
1	Prof. Dr. Artan Haxhi	artan.haxhi@unishk.edu.al
2	Prof. As. Dr. Zamira Shkreli	zamira.shkreli@unishk.edu.al
3	Dr. Ermira Alija	ermira.alijs@unishk.edu.al
4	Dr. Erzen Koperaj	erzen.koperaj@unishk.edu.al
5	Dr. Isida Hoxha	isida.hoxha@unishk.edu.al
6	Dr. Brikena Smajli	brikena.smajli@unishk.edu.al
7	Specialiste: Ardita Kopliku	ardita.kopliku@unishk.edu.al

